

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6400
E hënë, 30 gusht 2021
çmimi 0.40

BURIMET E DHUNËS NDAJ GRAVE

FAQE 7



Milazim KRASNIQI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**NDALOHEN VIZITAT FAMILJARE
PËR TË BURGOSURIT** F.5

**JASHARI MBAN DEGJIMET
BUXHETORE NË ÇDO BASHKESI
LOKALE TË SKENDERAJT** F.5

**FSK-ja TESTOHET PËR
MBËSHTETJE MJEKËSORE** F.3



EKONOMI

**BETEJA E KOSOVËS DHE
SERBISË PËR INVESTIME NË
VERI** F.8



SPORT



**BALLKANI MPOSHT PRISHTINËN
NË DERBI, GJILANI TRIUMFON
NDAJ 'NIKLIT'** F.10

NGA SOT (E HËNË) FILLON ZBATIMI I MASAVE TË REJA KUFIZUESE NË KOSOVË
KUNDËR COVID-19

FAQE 4-5

COVIDI RËNDON GJENDJEN, GJATË 24 ORËVE, EDHE 36 VIKTIMA



Foto ilustrim

Pandemia Covid-19 ka shtuar numrin e viktimave të dielën. Në 24 orët e fundit janë shënuar 36 raste të të vdekurve dhe janë infektuar 1 630 qytetarë. Kryeministri Albin Kurti ka anuluar vizitën në Austri dhe ka thirrur mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Opozita i ka bërë thirrje qeverisë që të kthehet në raport me pandeminë. Sipas përfaqësuesve të subjekteve opozitare, qeveria ka braktisur frontin kundër pandemisë

Shqipëria strehon 457 afganë

FAQE 2



Ndërroi jetë ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha

FAQE 5

RENOVA
PUTZ

Magedoni
Xhep isht
Tetov

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 0
+389 44 487 795
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.

ND, RTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin, Kosov,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Shqipëria strehon 457 afganë

TIRANË, 29 GUSHT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe ministrja e Punëve të Jashtme, Olta Xhaçka, kanë njoftuar se ka arritur në 457 numri i afganëve të strehuar në Shqipëri. "Arrin në 457 numri i afganëve që shpërngulen nga lufta dhe mirëpritën në Shqipërinë e besës e të respektit për kujtesën, traditën, vetveten, për të cilën sot flitet me admirim në gjithë opinionin ndërkombëtar", ka

shkruar Rama në rrjetet sociale.

Të premtën dhe të shtunën në Shqipëri arritën tri grupe me 275 shtetas afganë.

Autoritetet shqiptare kanë bërë me dije se bëhet fjalë për veprimtarë të shoqërisë civile dhe familjeve të tyre të cilët kanë punuar në organizata të ndryshme në Afganistan. Në mesin e personave të strehuar në Shqipëri ka edhe fëmijë. Shqipëria ka thënë se mund të

strehojë deri në 4 000 shtetas afganë të cilët po evakohen nga Afganistani, pasi talebanët morën kontrollin e shtetit.

Edhe Kosova dhe Maqedonia e Veriut janë shprehur të gatshme të strehojnë përkohësisht shtetas afganë të cilët kanë punuar me forcat e Shteteve të Bashkuara dhe të NATO-s. Autoritetet në Kosovë kanë thënë se do të strehojnë përkohësisht rreth 2 000 afganë.



Izraeli kryen sulme ajrore ndaj caqeve të Hamasit në Rripin e Gazës

GAZA, 29 GUSHT - Avionët izraelitë kanë goditur caqe të militantëve të Hamasit në Rripin e Gazës në orët e hershme të së dielës. Këto sulme vijnë pas përlëshjeve të ashpra në mes të protestuesve palestinezë dhe trupave izraelite përgjatë kufirit.

Ushtria izraelite tha përmes një deklaratë se avionët kanë bombarduar një ndërtesë të Hamasit në Rripin e Gazës, si kundërpërgjigje pas hedhjes së balonave me flakë në jug të Izraelit dhe protestave të dhunshme që janë mbajtur për dy javë me radhë, raporton "Associated Press".

Kryeministri i Izraelit, Naftali Bennett, foli për gazetaret në



Uashington, para se të nisej drejt Izraelit. Ai gjatë qëndrimit në ShBA u takua me presidentin amerikan Joe Biden. "Ne do të operojmë në Gaza sipas

interesave tona", ka thënë ai.

Të shtunën qindra aktivistë të mbështetur nga Hamasi mbajtën një protestë gjatë natës përgjatë kufirit me Izraelin, ku

hodhën eksplozivë drejt forcave izraelite, të cilat u përgjigjën me të shtëna armësh. Zyrtarët shëndetësorë në Gaza thanë se nga të shtënat e forcave izraelite janë plagosur tre persona.

Protesta përgjatë kufirit janë mbajtur gjatë gjithë javës. Organizatorët kanë thënë se protestat kishin për qëllim që të rrisnin presionin ndaj Izraelit për ta hequr bllokadën në territorin palestinez.

Izraeli dhe Egjipti janë përgjegjës për ruajtjen e bllokadës që prej se Hamasi mori kontrollin e Gazës përmes një grushtshteti dhe më pas fitoi zgjedhjet palestineze. Izraeli dhe Hamasi që atëherë kanë zhvilluar katër luftëra dhe

konflikti i fundit ishte në muajin maj. Bllokada kufizon lëvizjen e njerëzve dhe mallrave në Gaza.

Ndërkaq, Egjipti po punon që armëpushimi i arritur për t'u dhënë fund luftimeve të majit, të jetë ende në fuqi dhe duket se javën e kaluar është bërë përparim në këtë drejtim. Të paktën 260 palestinezë u vranë gjatë luftimeve në muajin maj ndërmjet Hamasit dhe Izraelit, përfshirë 67 fëmijë dhe 39 gra, thuhet në të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë në Gaza. Hamasi ka pranuar se 80 militantë janë vrarë në këto luftime. Ndërkaq në Izrael janë vrarë 12 civilë, përfshirë dy fëmijë dhe një ushtar izraelit.

Macroni: Franca dhe Britania do të propozojnë krijimin e një zone të sigurt në Kabul

PARIS, 29 GUSHT - Franca dhe Britania do të dorëzojnë një rezolutë gjatë mbledhjes urgjente të Kombeve të Bashkuara, të hënën, duke propozuar krijimin e një zone të sigurt në Kabul, me qëllim që të mbrohen njerëzit që po tentojnë të largohen nga Afganistani ka bërë me dije presidenti francez Emmanuel Macron. "Propozim-rezoluta jonë ka për qëllim që të

definojë një zonë të sigurt në Kabul, nën kontrollin e OKB-së, që do të lejonte vazhdimin e operacioneve humanitare", ka thënë Macron në një intervistë për gazetën "Le Journal du Dimanche" që u publikua të dielën.

Gjatë vizitës së tij në Mosul të Irakut, Macron kishte deklaruar se shpreson që një propozim i tillë të përkrahët. "Nuk shoh se

kush mund ta kundërshtojë vazhdimin e sigurt të operacioneve humanitare", ka deklaruar Macron për gazetaret. Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, ka thirrur takimin e Këshillit të Sigurimit për të diskutuar për Afganistanin. Macron të shtunën deklaroi se Franca do të zhvillojë diskutime me talebanët lidhur me situatën humanitare

në Afganistan dhe për mundësinë e evakuimit të më shumë njerëzve. Forcat amerikane, që ruajnë aeroportin e Kabulit, kanë filluar tërheqjen. Ata duhet të tërhiqen nga Afganistani deri më 31 gusht. Franca është në mesin e shumë vendeve që veçse kanë përfunduar operacionet e tyre të evakuimit nga aeroporti i Kabulit.



Mijëra persona në Luiziana evakohen si pasojë e uraganit Ida

LUIZIANA, 29 GUSHT - Uragani Ida ka kaluar në Gjirin e Meksikës dhe është rrugës që potencialisht të godasë keq bregdetin e shtetit jugor amerikan të Luizianës më 29 gusht, teksa zyrtarët kanë filluar që të hapin strehimore për njerëzit që po largohen nga uragani. Sipas meteorologëve, uragani Ida mund të jetë "jashtëzakonisht

i rrezikshëm". Ata e kanë klasifikuar këtë uragan si uragan i kategorisë 4, që karakterizohet me erëra mbi 200 kilometra në orë.

Dhjetëra-mijëra persona po largohen nga shtëpitë e tyre pasi zyrtarët urdhëruan evakuimin e qytetarëve nga zonat e ulëta bregdetare dhe bllokuan autostradat. Gjashtëmbëdhjetë vjet më

parë Luiziana dhe Misisipi u goditën keq nga uragani Katrina, që vrau më shumë se 1 800 persona.

Spitalet në Luiziana veçse janë të mbushura me pacientë nga vala e fundit e pandemisë së koronavirusit, që u shkaktua si pasojë e nivelit të ulët të vaksinimit dhe variantit më ngjites "Delta" dhe tani strehimoret,

për personat që po largohen nga shtëpitë e tyre, shtojnë rrezikun që të bëhen vatra të reja të përhapjes së infeksioneve të reja me Covid-19.

Shteti i Luizianës është shteti i tretë në ShBA që ka regjistruar më së shumti raste në 100 000 banorë në shtatë ditët e fundit.

Gubernuratori i Luizianës, John

Bel Edwards, tha më 28 gusht se strehimoret do të punojnë me kapacitet të reduktuar për "të reflektuar realitetet e Covid-19".

Zyrtarët e Luizianës po punojnë për të gjetur dhoma hotelesh për t'i vendosur personat e evakuuar, me qëllim që, sipas guvernatorit, sa më pak njerëz të strehohen në strehimore masive.

FSK-ja testohet për mbështetje mjekësore

PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se testimi i aftësive dhe kapaciteteve operacionale të Forcës së Sigurisë në mbështetjen mjekësore ROL 1, nga Qendra e NATO-s për Ekselencë (COE), është sukses i madh i radhës. Ai ka theksuar se, përveç përgëzimeve për specialistët

tanë, falënderim dhe mirënjohje e madhe për ekipet profesionale trajnuese të forcave amerikane si: Iowa Army National Guard, United States Air Force Europe - Surgeon General Office (USAFE-SG), MNBG-E, Bondsteel Camp dhe NALT. "Përveç shërbimit në mbështetje të operacioneve

luftarake në misionin e mbrojtjes së vendit tonë, ky kapacitet tanimë është i aftë dhe i gatshëm të marrë pjesë efektivisht në operacionet jashtë vendit, përkrah forcave aleate të udhëhequra nga ushtria amerikane. Vazhdojmë tutje drejt sukseseve të reja", ka shkruar Mehaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Ndërroi jetë ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 GUSHT - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, ka ndërruar jetë të dielën në moshën 73 vjeçe pas një sëmundjeje të rëndë. Lajmin për vdekjen e Berishës e ka dhënë djali i tij, Visar Berisha. Sipas familjarëve, Kolë Berisha do të varroset të hënën, më 30 gusht, në varrezat e Prishtinës, në praninë e rrethit të ngushtë familjar. "Për shkak të situatës së rëndë epidemiologjike dhe masave që prej sot janë në fuqi, nuk do të mund të organizojmë të pame për babën", ka shkruar Visar Berisha në llogarinë e vet në "Facebook".

Kolë Berisha ka qenë kryetar i Kuvendit të Kosovës nga viti 2006 deri më 2007. Ai ishte anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe për një kohë ka qenë edhe nënkryetar i kësaj partie.

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka thënë se me pikëllim të thellë e ka marrë lajmin për ndarjen nga jeta të Kolë Berishës. Ajo ka thënë se Kolë Berisha ishte një ndër veprimtarët më të shquar të lëvizjes për pavarësinë e Kosovës dhe bashkëpunëtor i ish-presidentit Ibrahim Rugova. "Sot ai u nda nga ne, duke na lënë të pikëlluar, por edhe krenarë për veprën e tij shumëdimensionale. Mësues i hershëm dhe idealist i madh, autor tekstesh letrare e veprimtar i pashoq politik, pajtues gjaqesh



e urë lidhëse mes njerëzish, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës e politikan i urtë, bacë Kola dha shembullin e njeriut i cili beson në idealin e lirisë dhe ia kushton tërë jetën asaj. Ndarja nga jeta e tij do të lë zbrazëti të madhe në jetën tonë publike. I përjetshëm qoftë kujtimi për të!", ka shkruar Osmani në llogarinë e saj në "Facebook".

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka ngushëlluar

familjen Berisha për vdekjen e anëtarit të tyre Kolë Berisha. "Kontributi i çmuar i bacës Kolë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës si aktivist i hershëm i LDK-së, për krijimtarinë e gjithëmbarshme si shkrimtar e intelektual, mbi të gjitha angazhimi i tij për themelimin dhe fuqizimin e institucioneve të Republikës së Kosovës si deputet e kryekuvendar, do të mbetet përherë në kujtimet tona", ka

shkruar Konjufca në llogarinë e vet në "Facebook".

Familjen Berisha e ka ngushëlluar edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku. "E nderuar familje Berisha, mëngjesi i sotshëm nuk ishte i dhimbshëm vetëm për ju, por edhe për Lidhjen Demokratike si dhe krejt Kosovën. Ju humbët babanë e familjarin tuaj, ne humbëm mikun,

bashkëpunëtorin, ish-nënkryetarin e LDK-së, ndërsa Kosova humbi patriotin e orëve më të vështira të vendit tonë, politikanin e madh dhe luftëtarin e palodhur që punoi shumë për liri, pavarësi dhe demokraci. Vdekja e Kolë Berishës është lajm pikëllimi e dhimbjeje për Kosovën, për kolegët dhe gjithë miqtë", ka thënë lideri i LDK-së në telegramin ngushëllues.

Kurti dhe eurodeputeti Waitz bisedojnë për mbrojtjen e ambientit, bujqësinë dhe zhvillimin rural

PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka prituri në takim deputetin e Parlamentit Evropian nga Partia e Gjellbër e Austrisë, njëherësh bashkëkryesues i Partisë së Gjellbër Evropiane, Thomas Waitz, me të cilin kanë biseduar për mbrojtjen e ambientit, bujqësinë dhe

zhvillimin rural. Kryeministri Kurti dhe Waitz diskutuan për mbrojtjen e pyjeve dhe agjendën e gjellbër të Kosovës dhe ndihmën që Bashkimi Evropian mund të ofrojë në këtë drejtim. Eurodeputeti Waitz u interesua për çështjen e hidrocentraleve dhe qëndrimin e qeverisë për hidrocentralet e vogla,

mbrojtjen e lumenjve dhe sigurimin e ujit për pije dhe ujë. Në këtë takim u bisedua edhe për zhvillimin e sektorit të bujqësisë nëpërmjet përkrahjes së fermave, transformimit të zonave rurale në vende tërheqëse për punë dhe jetesë, si dhe për ndërtimin e sistemeve ushqimore të qëndrueshme.





NGA SOT (E HËNË) FILLON ZBATIMI I MASAVE TË REJA KUFIZUESE NË KOSOVË KUNDËR COVID-19

Covidi rëndon gjendjen, gjatë 24 orëve, edhe 36 viktima

Pandemia Covid-19 ka shtuar numrin e viktimave të dielën. Në 24 orët e fundit janë shënuar 36 raste të të vdekurve dhe janë infektuar 1 630 qytetarë. Kryeministri Albin Kurti ka anuluar vizitën në Austri dhe ka thirrur mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Opozita i ka bërë thirrje qeverisë që të kthehet në raport me pandeminë. Sipas përfaqësuesve të subjekteve opozitare, qeveria ka braktisur frontin kundër pandemisë

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 29 GUSHT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë shënuar 36 raste të të vdekurve. Shtatë prej viktimave janë nga komuna e Gjakovës, katër nga Prizreni, nga tri viktima janë regjistruar në Gjilan dhe Klinë, nga dy viktima në Prishtinë, Pejë, Rahovec dhe Vushtrri, ndërkaq nga një viktima në Viti, Semetisht, Fushë-Kosovë, Vrellë, Suharekë, Cerrcë, Kamenicë, Carravranë, Ferizaj, Podujevë dhe Malishevë. Sipas

MSh-së, njëmbëdhjetë viktima bënë pjesë në grupmoshën 60-69 vjeç, tetë ishin të grupmoshës 80 vjeç e sipër, nëntë në atë 70-79 vjeç, tri viktima të grupmoshës 50-59, tri të grupmoshës 30-39 vjeç, një viktima i përkiste grupmoshës 40-49 vjeç dhe një viktima ishte e grupmoshës 20-29 vjeç.

Gjatë kësaj periudhe kohore 1 630 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me këtë virus. "Prej 11 017 testeve, 1 630 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë

shënuar edhe 36 raste të të vdekurve. Sot janë shënuar 816 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve është 113 699", ka njoftuar MSh-ja.

Po kjo ministri ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë dhënë 11 458 doza të vaksinës kundër Covidit. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 11 458 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 808 078 doza të vaksinës. Deri më sot 269 312 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë", ka njoftuar ministria.

Qeveria po e braktis frontin ndaj pandemisë

Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, Blerand Stavileci, ka kritikuar qeverinë për menaxhimin e keq të pandemisë. Në konferencë për media, ai ka thënë se Kosova po e përjeton periudhën më të errët të pandemisë, me shumë humbje jetësh dhe me shumë rrëmujë e aspak menaxhim dhe rregullsi. "Shifrat e rasteve të vdekjeve dhe të infektimit janë alarmante. Ato po shtohen nga dita në ditë me një shpejtësi të frikshme. Pasojat po bëhen edhe më të rënda. Kriza po thellohet dhe tashmë ajo është shndërruar në tragjedi njerëzore. Vetëm në 12 ditët e fundit kemi pasur 24 115 raste të reja infektimi dhe 136 humbje jetësh", ka thënë

Stavileci.

Ai ka deklaruar se qendrat e vaksinimit në Kosovë janë të pakta dhe ato nuk janë shtuar fare në raport me rritjen e rasteve. "Nuk ka terminë të lirë për vaksinim dhe nuk ka fare transparencë për sasinë e vaksinave. Gjatë tërë pranverës dhe verës ka pasur vaksinime të pakta. Me muaj të tërë të kaluar e askush dhe asgjë nuk është menaxhuar", është shprehur ai.

Stavileci ka vlerësuar se qeveria aktuale ka braktisur frontin kundër pandemisë dhe, si rrjedhojë, tani po shihen pasojat fatkeqe në shëndetësi, siguri, ekonomi dhe arsim. "Vija e parë e frontit kundër pandemisë, mjekët, infermierët dhe i tërë personeli shëndetësor janë të stërngarkuar e të stërlodhur, por ata janë lënë të vetëm e në distancë nga një qeveri e cila arriti ta dizajnojë krizën më të



madhe shëndetësore dhe kolapsin e krejt sistemit shëndetësor. Dhe, për ironinë më të madhe të fatit të tyre, jo që u ndihmoi, por i ofendoi me nga 2 euro në ditë”, ka deklaruar Stavileci, duke shtuar se mungesa e menaxhimit dhe pandjësia ndaj kësaj tragjedie ka rritur ankthin e qytetarëve.

Stavileci ka propozuar shtim të qendrave të vaksinimit, krijim të ekipeve mobile të vaksinimit nëpër lagje e fshatra, vaksinim gjatë fundjavës, mundësi të zgjedhjes së qytetit për t’u vaksinuar, fushata ndërgjegjësuese, shtim të stafit shëndetësor dhe motivim adekuat. “Qytetarët nuk mund ta mbajnë të vetmuar barrën edhe të një mbylljeje tjetër. As bizneset dhe punëtorët. As arsimtarët dhe nxënësit. Një menaxhim i munguar do të shkaktojë humbje të reja jetësh, ndërkaq një menaxhim i mirëfilltë do të mund të shpëtonte shumë prej tyre”, ka thënë ai.

Edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka kritikuar qeverinë. Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se përtej politikës, ky pushtet e kjo klasë politike duhet të kthjelllet. “Situata është jashtëzakonisht e rëndë dhe nuk menaxhohet me takime rutinë e me masa sipërfaqësore. Qeveria duhet t’i orientojë krejt potencialet

njerëzore e financiare në mbrojtje të shëndetit të popullit. Detyrë mbi detyrat sot është mposhtja e sëmundjes së shekullit. Me shpresë se ky i sotmi është rekordi i fundit i zi, e ftoj kryeministrin Kurti ta kuptojë seriozitetin e gjendjes së krijuar dhe të veprojë në përputhje me situatën. Atyrë që sot e gjithë këto ditë i kanë humbur të dashurit e tyre, ngushëllimet më të sinqerta”, ka shkruar Haradinaj.

Lidhur me situatën pandemike ka reaguar edhe deputeti nga radhët e LDK-së, Besian Mustafa. “Bilanc luftë! 70 vdekje në 72 orët e fundit. Pra, çdo orë vdes nga një qytetar. Një familje humb babanë, nënën, vajzën, djalin, motrën, vëllanë, gjyshen...çdo orë, 24 orë në ditë. ‘Populli i ka fajet’ thonë, se ‘nuk po vaksinohet’. E diel. 36 anëtarë të familjeve tona vdiqën sot. Qendrat e vaksinimit kanë pushim. Terminë të lira nuk ka”, ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në “Facebook”.

Fillon zbatimi i masave të reja kufizuese

Qeveria e Kosovës të shtunën ka vendosur për masat e reja për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. Masat e reja kufizuese do të fillojnë të zbatohen nga sot (e hënë). Masat përfshijnë që viti i ri

shkollor të nisë më 13 shtator. Në masat e reja përfshihet kufizimi i lëvizjes së qytetarëve nga ora 22:00 deri në orën 05:00. Orari i sektorit të gastronomisë është reduktuar për një orë dhe ky sektor tashmë do të mund të punojë deri në orën 21:30 dhe do të lejohet të punojë vetëm në hapësira të jashtme. Institucionet publike dhe private janë të obliguara të punojnë vetëm me staf esencial deri më 13 shtator. Pas kësaj date punëtorët e sektorit publik duhet të dëshmojnë certifikatën e vaksinimit apo testet përkatëse që t’u lejohet hyrja në vendet e punës. Po ashtu, të gjithë personat që do të hyjnë në Kosovë, pavarësisht prej shtetësisë, duhet të ofrojnë dëshmi për vaksinim apo teste PCR dhe antigjen, në të kundërtën duhet të izoloohen për shtatë ditë.

Ndalohen vizitat familjare për të burgosurit

Prishtinë, 29 gusht (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës në bashkëpunim me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve, bazuar në vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të pandemisë në vend, me qëllim të ruajtjes së shëndetit të të burgosurve dhe stafit, nga data 31 gusht deri më 15 shtator ka ndërmarrë tetë masa në lidhje me këtë situatë. “Ndalimin e

përkohshëm të të gjitha vizitave familjare për të burgosurit në institucionet korrektuese; Ndalimin e të gjitha vikendeve në shtëpi për të dënuarit; Ndalimin e punës për të dënuarit jashtë Institucioneve Korrektuese; Ndalimin e vizitave në lokalet e veçanta; Aplikimin e sistemit virtual të komunikimit SKYP për të burgosur për të zhvilluar kontakte me familjet, sipas rutinës së përcaktuar nga Institucioni; Lejimin e numrit të shtuar të thirrjeve telefonike gjatë kësaj periudhe; Kufizimin e transferimeve të burgosurve (vetëm rastet e domosdoshme); Lejimin e kontaktit të të paraburgosurve me mbrojtësit e tyre për rastet që janë në zhvillim, me masat e parapara në urdhrin paraprak; dhe masat e ndërmarra me urdhrin operativ të datës 20.08.2021, të cilat nuk bien ndesh me këtë urdhër mbesin në fuqi”, është bërë me dije në njoftimin e ShKK-së.

Përfundimisht nga ky urdhër bëjnë Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organizatat që bëjnë monitorimin e të drejtave të njeriut, me të cilat MD/SHKK ka marrëveshje mirëkuptimi.

Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar se do ta vazhdojë bashkërendimin institucional me institucionet relevante të Republikës së Kosovës dhe do të mbajë të informuar opinionin publik rreth hapave në vazhdim.



Largohen 400 thasë me mbeturina përreth liqenit të Batllavës

PODUJEVË, 29 GUSHT (ER) - Komuna e Podujevës ka bërë me dije se është bërë pastrimi përreth liqenit të Batllavës nga organizata "SDK" dhe kompania rajonale e pastrimit "Pastrimi". Nga ky aksion janë

larguar rreth 400 thasë me mbeturina. Me këtë rast, kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka thënë se janë duke u angazhuar për një ambient të pastër. "Ne si institucion tashmë kemi

nënshkruar kontratë me kompaninë e pastrimit, e cila do të mirëmbajë në vazhdimësi hapësirat përreth liqenit. Bashkë për ambient të pastër e të shëndetshëm", ka thënë Bulliqi.



Jashari mban dëgjimet buxhetore në çdo bashkësi lokale të Skenderajt

SKENDERAJ, 29 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kastriot Gashi, kryesuesen e Kuvendit Komunal, Fatbardha Haliti, drejtorë të drejtorive, kanë mbajtur dëgjimet buxhetore në çdo bashkësi lokale të kësaj komune.

Kryetari Jashari i ka inkurajuar qytetarët e çdo fshati që t'i paraqesin kërkesat dhe shqetësimet që ata kanë në mënyrë që ato të përfshihen në buxhetin e komunës për vitet 2022-2024. Kurse drejtori i Drejtorisë së

Financave, Kastriot Gashi, ka raportuar lidhur me projektet që janë realizuar brenda një viti, të cilat në masë të madhe kanë përmirësuar mirëqenien e qytetarëve të Skenderajt. Po ashtu, para të pranishëmve janë shpalosur synimet e komunës për buxhetin e vitit 2022 dhe planifikimin për vitet 2023 dhe 2024, ku janë paraqitur r projektet që do të zhvillohen në lokalitetet e tyre, ndërsa të pranishmit në këto takime buxhetore kanë dhënë rekomandimet e tyre, kërkesat për projektet që janë me interes për komunitetin ku ata jetojnë.



Nis asfaltimi i rrugës kryesore në Pogragjë të Gjilanit



GJILAN, 29 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka marrë pjesë në fillimin e asfaltimit të rrugës kryesore të fshatit Pogragjë. Me këtë rast, Haziri ka thënë se ky fshat është model i organizimit dhe investimeve. "Jam i kënaqur që e filluam asfaltimin e rrugës kryesore në Pogragjë. Fshat model i organizimit, investimeve dhe përkushtimit ndaj të mirës së përgjithshme, falë bashkëpunimit trepalësh në mes të komunës, këshillit të fshatit dhe Shoqatës 'Pogragja' me seli në Zvicër. Përpos

asfaltimit të rrugës kryesore, planifikimi i komunës ka paraparë edhe projektin rekreativ të lumit Llapushnica, hapjen e Kalasë së Pogragjës dhe trajtimin e lumit Morava në kuadër të projektit të madh Floës, që përfshinë tri komuna", ka thënë Haziri.


Më tutje, ai ka thënë se do të vazhdojnë investimet në fshatrat model si Pogragja, Dobërçani, Zhegra, Cërnica, Llashtica, Bresalci, Malisheva, Përlepница, Velekinca, Livoçi i Epërm, Livoçi i Poshtëm dhe në të gjitha vendbanimet e tjera.

I mituri rrah konduktorin në Prishtinë vetëm pse i kërkoi ta vendoste maskën

PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Konduktori i një autobusi është goditur me grushte dhe shqelma nga një i mitur pasi paraprakisht i ka kërkuar ta vendoste maskën për të hyrë në autobus. Sipas viktimës, sulmi fizik ka ardhur për shkak të maskës. Me vendim të prokurorit i mituri i dyshuar është dërguar në ndalim policor në kohëzgjatje prej 24-orësh. "Është arrestuar i dyshuari i mitur mashkull kosovar pasi që i njëjti e kishte sulmuar fizikisht viktimën

mashkull kosovar. Viktima ka deklaruar se derisa ka qenë duke punuar si konduktor në autobus, nga i dyshuari kishte kërkuar që për të hyrë në autobus duhet të vendosë maskën, ndërsa i dyshuari e kishte sulmuar duke e goditur me grushte dhe shkelma. Viktima nuk ka pranuar tretman mjekësor, ndërsa me aktvendim të prokurorit kujdestar të dyshuarit i është caktuar masa e ndalimit policor për 24 orë", ka njoftuar Policia e Kosovës.





Milazim KRASNIQI

BURIMET E DHUNËS NDAJ GRAVE

Dhuna fizike dhe psikike ndaj grave ndër shqiptarë, duke përfshirë edhe vrasjet më barbare, siç ishte edhe vrasja e Marigona Osmanit në Ferizaj, është si sëmundje kronike së cilës nuk i është gjendur terapia. Është e hidhur ta thuash, por e vërtetë që kjo është si një sëmundje kronike, e cila i ka rrënjët thellë në trashëgiminë tonë primitive, prej së cilës nuk jemi çliruar kurrë plotësisht. Trashëgimia primitive mbijeton dhe ndikon në një komunitet a shoqëri të frikësuar, të paqëndrueshme e me institucione të dobëta, ngase në atë rast u shërben grupeve më të forta, që praktikisht imponojnë diskursin dominant dhe më tutje marrin në dorë ligjin.

Shikojeni këtë tablo pragjike të trashëgimisë sonë primitive, ku femra shqiptare ka qenë objekt dhe cak dhune, poshtërimi, diskriminimi dhe krimi, trashëgimi që ndonëse e denoncuar si primitive dhe barbare, në forma okulte e bizare ende mbahet në veprim. Fjala vjen, në Kanun gruaja është një objekt shitje-blerjeje, pra shitej me para, blihej me para. Ajo nuk kishte asnjë të drejtë, madje as të zgjidhte rrobat e veta për nusëri. Nuk kishte të drejtë në trashëgiminë në familjen e burrit (përveç kur mbetej e vejë me fëmijë të vëgjël, në atë rast mund ta administronte atë pasuri derisa fëmijët të rriteshin.) Nuk kishte trashëgimi as te prindërit. Vlera e saj përmendej vetëm kur lindte djem (jo vajza!) Nëse nuk lindte djem, burri mund të merrte edhe një grua tjetër. Sigurisht gruaja vlerësohej edhe kur kryente punë të rënda fizike, në vend të meshkujve, kur ata ishin të ngujuar, shkaku i gjakmarrjes. Kur e nisnin nuse, dhëndrit ia dërgonin një plumb, me të drejtën që ta vriste, nëse nuk ishte e virgjër! (Ndërsa e virgjër mund të mos ishte nga rreziku se mund të ishte në adoleshencë e dhunuar nga ndonjë kapadai brenda ose

jashtë fisit.) Nëse e rrihte burri, pa i dalë gjak, kjo nuk paraqiste problem a nevojë për ta marrë në mbrojtje. Vetëm nëse i dilte gjak nga ajo rrahje e burrit të saj, reagonte familja e bëhej përpjekje të ndalohej dhuna ndaj saj. Gruaja nuk kishte të drejtë të ishte as dëshmitare. Nëse një vajzë e pamartuar mbetej shtatzënë, fati tragjik i saj ishte i vulosur. (Franc Nopça, njëri nga studiuesit më të mirë të Kanunit, ka sjellë një rrëfim për një vajzë të cilën meqë kishte ngelë shtatzënë, e kishin mbyllur në një si kamare, ku i kishin lënë një dritarez sa t'i jepnin bukën dhe ku ajo kishte vdekur. Faktikisht ishte një lloj i murimit për së gjalli!)

Barbaritë si këto ndaj femrës ndër shqiptarë, të evidencuara nga Nopça dhe nga studiues e vëzhgues të tjerë, janë të shumta, të tmerrshme. Fatkeqësisht, disa nga normat e Kanunit të Lekë Dukagjinit kanë qenë aktive edhe në hapësirat e Kosovës, veçmas në sferën e gjakmarrjes dhe të diskriminimit brutal të femrës. Regjimi serbomadhi do ta ketë nxitur të mbahej Kanuni sa më aktiv, sepse prodhonte dhunë, tragedi dhe fragmentim social ndër shqiptarë, me çka mbajtja e tyre nën okupim sigurisht ka qenë e lehtësuar. Pra, edhe gjatë periudhës së gjatë të sundimit serb e jugosllav, (1912-1999) shqiptarët e Kosovës nuk kanë pasur mundësi të duhura të shkëputjes nga trashëgimia primitive ndaj femrës, as liri veprimi për transformimin dhe emancipimin e mirëfilltë të individit, të familjes e të shoqërisë. Shitblerjet e femrave kanë mbetur aktive në shumë familje e në shumë zona deri vonë, dhuna e burrit ndaj gruas ka mbetur e përlligjur, diskriminimi i saj, duke ia mohuar edhe të drejtën e trashëgimisë pronësore, ka mbetur dominant. Absurd më vete është fakti që këto forma të diskriminimit kanë mbetur të forta edhe gjatë periudhës së regjimit komunist, i cili kishte

proklamuar emancipimin e femrës dhe pozitën e saj të barabartë në shoqëri. Duke u bërë pronarë të shtetit, komunistët e filluan procesin e emancipimit të femrës, me tentativën për shkatërrimin e familjes si institucion e rrjedhimisht edhe me abuzime masive seksuale e tradhti bashkëshortore nëpër kooperativa e ndërmarrje të tjera shtetërore. Çmoralizimi komunist për të cilin Brzhezinski thotë se është pasojë më e madhe që ka lënë komunizmi, ka prekur rëndë edhe integritetin e femrës, e cila thjesht ishte viktimë e mujsharisë mashkullore, që dirigjonte tërë sistemin komunist. Madje edhe në vitet të thuasht më normale që kanë pasur shqiptarët nën Jugosllavi, në vitet shtatëdhjetë, diskriminimi dhe presioni ndaj femrave ka qenë sistematik. Ishte sistematik dhe heshtazi i lejuar, madje deri edhe në shkollat e mesme, ku rrugaçë të ndryshëm tentonin të papenguar që të rrëmbenin a dhunonin nxënëse, kur dilnin nga shkolla në mbrëmje. Po ashtu janë të njohura tregimet po edhe dëshmitë për disa udhëheqës komunistë të asaj kohe, që merrnin femra e abuzonin me to në mënyrën më imorale të mundshme, gjithnjë duke abuzuar fuqinë që u jepte pushteti totalitar. Pra, jo vetëm periudha e kanunit dhe e regjimit monarkist serb, po edhe periudha e socializmit, ishte skëterrë për femrën shqiptare në këto hapësira. Periudha e spastrimit etnik dhe e gjenocidit serb të viteve 1998-1999 sigurisht është më e llahtarshme, sepse në atë periudhë u përdorën dhunimet e femrave shqiptare si mjet lufte, për nxitjen e debimeve dhe të thyerjes së rezistencës. Tragedia e kësaj periudhe ende nuk e ka gjetur përgjigjen adekuate, as nga shoqëria e as nga drejtësia. Mund të mos jetë faktori kryesor, por ka gjasa që qëndrimi i rrënjësor

mashkullor për fajësinë apriori të femrës, është në themelet e këtij mosveprimi. Nuk do të mund të nxirrej kjo hipotezë, po të mos shoqërohej mosveprimi për ta çuar drejtësinë në vend, me tentimet për abuzim masiv me femrat në shoqërinë tonë të re nga mujsharët e rinj që u veshën me pushtet pas çlirimit. Janë raportuar raste të kushtëzimeve të punësimit me shërbime seksuale, madje edhe të notimeve në universitete, por as në këto raste drejtësia nuk ka reaguar në mënyrën e duhur. Madje as politika. Kësodore, femra ka mbetur viktimë e mujsharisë së shfrenuar mashkullore edhe në liri, kur ajo ka ëndërruar se do të çlirohej përfundimisht nga prangat e diskriminimit dhe të dhunës. Përkundrazi, kësaj tabloje tashmë i është shtuar edhe pjesa e dhunës së shfrenuar nga kriza e re e familjes si pasojë e hedonizmit e konsumerizmit të shfrenuar, ku kanë dalë edhe aktorë të ri dhunues, me serratet e drogaxhive dhe personave me çregullime psikike.

Me të gjitha këto trashëgimi të hidhura e me këtë aktualitet po ashtu të hidhur, shoqëria jonë ende reagon e topitur, në mënyrë reaktive, kur ndodhë ndonjë tragedi, si kjo e fundit me Marigona Osmanin. Por, jo si një projekt i cili do ta vinte në plan të parë mbrojtjen e femrës nga dhuna psikike e fizike, nga diskriminimi, nga mohimi i trashëgimisë, nga kushtëzimet për shkollim e punësim. Në këtë mes, nuk mjaftojnë reagimet e shoqatave të grave. Ato janë të rëndësishme, por të pamjaftueshme, nëse shoqëria nuk reagon e politika nuk mobilizohet. Ndërsa, shoqëria nuk po reagon, politika nuk po mobilizohet. As shoqëria e as politika nuk e kanë kuptuar ende se problemi është më thellë, te ajo trashëgimi e paçrrenjosur, e cila femrën e kishte objekt legal të tregtimit, të dhunës, të diskriminimit, të shfrimit libidal. Po të ishte e

shkëputur shoqëria dhe politika nga ajo trashëgimi, do të bënte disa veprime, për ta ndalë këtë terror psikik e fizik ndaj femrave e nuk do të mjaftohej me fjalime hysterike të politikanëve, të cilat që të nesërmen harrohen. Fjala vjen, do të mund të miratohej një ligj që do të jepte mundësi punësimi me prioritet femrave, që ato të mos kushtëzohen me shërbime seksuale për punësim. Po ashtu mund të caktohet një përqindje solide për pozita drejtuese në institucionet shtetërore e publike për femrat. Do të duhej të ndalohej me ligj që femra të privohet "vullnetarisht" nga trashëgimia në familje siç bëhet shumë shpesh. Paditë që bëjnë gratë për dhunë psikike e fizike nga burrat e tyre, do të duhej të procedoheshin me urgjencë nëpër prokurori e gjykata. Natyrisht edhe arsimit publik mund të kontribuojë, por jo ky si është sot, me programe shkollore që në koncept mbrojnë trashëgiminë kanunore dhe jo me mësues që në një numër të konsiderueshëm janë produkt i asaj mendësie. Sidoqoftë, mundësi përmirësimi gjithsesi ka. Tash për tash mungon vullneti shoqëror e vullneti politik. Mungon vullneti, sepse trashëgimia primitive ende shërben si sentiment a si narkotik në këtë vend. Fatkeqësisht, jemi shoqëri që ende nuk jemi liruar nga frika, rrjedhimisht as nga dhuna. Ne fillimisht duhet ta kuptojmë se jemi shoqëri që ka qenë dhe ende është viktimë e dhunës. Pastaj të kërkojmë rrugët më efikase të shkëputjes prej kësaj trashëgimie të llahtarshme, ku viktimat më të goditura janë dy grupet sociale më të pafajshme, gratë dhe fëmijët. Në këtë aspekt, jemi edhe shoqëri e mbuluar nga turpi, të cilin në vend se ta fshijmë, me ligje të reja e me një kulturë të re, vazhdojmë ta fshehim me mjetet e vjetra të mujsharisë primitive.

(29 gusht 2021)

Beteja e Kosovës dhe Serbisë për investime në veri

PRISHTINË, 29 GUSHT - Në komunat me shumicë serbe në veri të Mitrovicës, për dallim prej komunave të tjera me shumicë serbe në Kosovë, vazhdojnë të investojnë edhe Kosova edhe Serbia. Në këto komuna, po ashtu, investohet edhe nga Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit. Pavarësisht prej investimeve të shumta, qytetarët e Mitrovicës së Veriut nuk janë të kënaqur dhe kërkojnë më shumë investime në prodhim që do të rriste numrin e të punësuarve. Ndërkaq shoqëria civile në Prishtinë vlerëson se ka mungesë të transparencës sa iu përket investimeve kapitale në këto komuna.

Investimet e Serbisë në veri

Serbia nga buxheti i saj për vitin 2021 ka ndarë 91.8 milionë euro për financimin e institucioneve paralele dhe aktiviteteve të saj në Kosovë. Pjesa më e madhe e shumës prej 91.8 milionë eurosh që është ndarë për Zyrën për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, rreth 43.7 milionë euro shkon për ta mbështetur funksionimin e institucioneve paralele dhe organizatave të tjera në Kosovë. Serbia do të investojë mbi 23 milionë euro për përmirësimin e cilësisë së jetës së popullatës serbe dhe joshqiptare që jeton në Kosovë.

Nga buxheti i ndarë për Kosovën nga qeveria serbe rreth 2.59 milionë euro janë për "mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, mbështetjen e Kishës Ortodokse Serbe dhe aktivitetet kulturore". Po ashtu, përmes Ministrisë së Arsimit të Serbisë ndahen rreth 23.8 milionë euro për ta mbështetur punën e të ashtuquajturit Universiteti i Prishtinës me qendër në Mitrovicën e Veriut, i cili punon sipas sistemit arsimor të Serbisë. Serbia dhe Kisha Ortodokse Serbe përmes një investimi prej 14 milionë eurosh është duke e përfunduar "Luginën e Diellit" në Zveçan, që përfshin ndërtimin e 300 njësjive banesore.

Investimet e Kosovës në veri

Në projekte kapitale në këto komuna do të investojë edhe Qeveria e Kosovës. Në bazë të të dhënave të Projektbuxhetit për vitin 2021, shteti i Kosovës ka ndarë rreth 10 milionë euro për këto katër komuna.

Ministria e Financave ka bërë me dije se nga buxheti mbi 4 milionë euro të ndara për komunën e Leposaviqit, mbi 1.5 milion euro

janë për investime kapitale.

Është paraparë zgjerimi i rrugës me katër korsi: Leposaviq-Mitrovicë-Klinë e Epërme-Runik-Istog që ka vlerën mbi 2.3 milionë euro.

Në plan është edhe rregullimi i ndriçimit të rrugëve në territorin e komunës së Leposaviqit në vlerë mbi 106 mijë euro.

Ndërtimi dhe riparimi i urave në komunën e Leposaviqit, ndërtimi i morgut në fshatrat e kësaj komune dhe përfundimi i ndërtimit të një qendre shpirtërore dhe shtëpizës së gjuetisë në Leposaviq, që në total kanë vlerë mbi 200 mijë euro.

Buxhet për komunën e Zveçanit është ndarë mbi 2.2 milionë euro, ku mbi 330 mijë euro janë për investime kapitale.

Shuma më të mëdha do të investohen në Mitrovicën e Veriut. Për këtë komunë nga qeveria janë ndarë rreth 5 milionë euro dhe mbi 1.3 milion euro janë për shpenzimet kapitale.

Është paraparë që të bëhet rikonstruktimi i fasadave të ndërtesave në disa rrugë në vlerë mbi 770 mijë euro.

Pastaj rikonstruktimi i infrastrukturës në rrugët "Xhon Kenedi" dhe "Mesud Djekoviç" në vlerë rreth 500 mijë, si dhe rikonstruktimi i rrokaqiellit të UN-it në vlerë 600 mijë euro. Rreth 2 milionë euro janë ndarë për Zubin Potokun dhe mbi 320 mijë euro janë për investime kapital, e që do të shpenzohen për ndërtimin e kanalizimit për ujëra atmosferike, për rregullimin e ndriçimit, për asfaltimin e rrugëve, për renovimin dhe rregullimin e ambulancave dhe për rikonstruktimin e objekteve shkollore.

Investime edhe nga Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit

Në zyrën e Bashkimit Evropian (BE) në Prishtinë kanë thënë për "Radion Evropa e Lirë" se që nga fillimi i tij në vitin 2013, bordi menaxhues i Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit ka aprovuar mbi 30 projekte, duke ndarë mbi 14 milionë euro për projekte të ndryshme. Ky fond aktualisht ka në dispozicion mbi 2.5 milionë euro, është thënë në përgjigjen e Zyrës së BE-së. Paratë e mbledhura në këtë fond janë përmes mallrave që importohen në pikat kufitare në veri, përkatësisht në Jarinë dhe Bërnjak.

Diana Metushi-Krasniqi nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (KDI) ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se investimet në komunat në veri të Mitrovicës janë politike. Sipas saj, sa iu



përket investimeve kapitale në këto komuna, mungon transparencë, zero llogaridhënie në çdo nivel të shpenzimit të parasë publike në veri të Kosovës. Nuk merret askush me aspektin llogaridhënës se çfarë është duke ndodhur me ato investime kapitale", ka thënë ajo. Kjo, sipas saj, ka bërë që të gjitha investimet kapitale në komunat me shumicë serbe në veri të kryhen vetëm nga një kompani, e cila është e pakonkurrencë dhe nuk asnjë ofertues tjetër.

Qytetarët në veri, të pakënaqur me investimet

Pavarësisht prej këtyre shifrave, disa qytetarë të Mitrovicës së Veriut kanë thënë për "Radion Evropa e Lirë" se duhet të ketë më shumë investime.

Miodrag Antiq nga kjo komunë ka thënë se investimet më të mëdha bëhen nga Serbia. "Në kohën e fundit ka investime më të mëdha, në krahasim me më herët. Mendoj se më shumë investon qeveria jonë serbe, se ne mbështetemi në të. Duhet të ketë investime në infrastrukturë, por më shumë edhe në fabrika, për të mbajtur këtë rini këtu", ka thënë Antiq.

Njëjtë si ai mendojnë edhe Zorica dhe Alberti, po ashtu qytetarë të kësaj komune. "Unë mendoj se mund të investojnë edhe më shumë, por nuk pyetet Serbia për të gjitha. Kosova për veriu asgjë nuk investon", ka thënë Zorica. "Serbia investon më shumë aty ku ka më shumë

interes, e Kosova çfarëdo që provon të investojë, ndërpriten. Është investuar edhe në urën kryesore, por nuk është hapur ende. Por, mendoj se ka arsye që po investon më pak", ka thënë Alberti.

Qytetarët Etem Peci dhe Gjorgje Stankoviç kanë thënë se investimet duhet të fokusohen më shumë në hapjen e vendeve të reja të punës. "Nuk di sa po investohet. Unë jam taksist, ku ta di. Investime më të mëdha duhet në vende të punës", ka thënë Peci. "Pjesërisht po ka investime, por besoj që duhet më shumë. Mendoj se Serbia më shumë investon, jo Kosova. Investime më të mëdha duhet të jenë në kapacitete prodhuese, që të ketë vende pune. Fshatrat gjithmonë janë me më pak njerëz", ka thënë Stankoviç.

Zëvendëskryetarja e komunës së Mitrovicës së Veriut, Adrijana Hoxhiq, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se buxheti i ndarë për komunat është shumë i vogël dhe nuk mund të përmbushen kërkesat e qytetarëve. "Kërkesat e qytetarëve janë shumë më të mëdha. Të gjitha këto kërkesa të qytetarëve janë të arsyeshme, por të gjithë duhet ta kuptojnë se komunat mund të reagojnë aq sa kanë buxhet. Qeveria duhet të ketë më shumë vëmendje nga niveli lokal", ka thënë Hoxhiq. Ajo ka thënë se qëllimi i komunës së Mitrovicës së Veriut është që ambienti i jetesës së qytetarëve të jetë sa më kualitativ, sidomos në këtë kohë të pandemisë. Hoxhiq ka thënë se nuk ka informacione se në çfarë projektesh dhe çfarë investimesh realizon shteti i Serbisë.

Çfarë është Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit?

Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit është themeluar mbi bazën e Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013 për doganat. Prishtina dhe Beogradi me lehtësimin e Bashkimit Evropian qenë pajtuar atëkohë për themelimin e tij në funksion të zhvillimit të komunave në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe.

Sipas kësaj marrëveshjeje, paratë e mbledhura përmes mallrave që importohen në pikat kufitare në veri, përkatësisht në Jarinë dhe Bërnjak, të destinohen në Fondin për zhvillimin e katër komunave veriore: Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit. Destinimi i Fondit ndërlidhet me projektet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike, përfshirë rrugët, spitalet, furnizimin me ujë, trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave.

Po ashtu, Fondi mbështet edhe projektet për bizneset, gratë, shoqërinë civile, promovimin e të drejtave të njeriut, arsimin, qasjen në kujdesin shëndetësor dhe transportin.

Funksionimi i Fondit vendoset nga bordi menaxhues dhe bordi përbëhet nga tre anëtarë: i dërguari i posaçëm i BE-së në Kosovë ka postin e kryetarit, ministri i Financave të Kosovës merr pjesë në emër të autoriteteve të Kosovës dhe një përfaqësues i komunitetit serb që vjen nga katër komunat veriore.



SHKRIMTARJA DANIELLE STEEL PUNON 20 ORË NË DITË, POR A DUHET PASUR ZILI?

Nga Oliver BURKEMAN

Deri më sot romancierja e njohur Danielle Steel ka shkruar 179 libra, duke i botuar ato me ritmin e 7 titujve në një vit. Dhe për aq sa di, ajo mund të jetë duke publikuar ndonjë libër të ri këto ditë. Por si ia del ta bëjë këtë? Në një intervistë të dhënë në muajin maj për revistën "Glamour", Steel zbuloi sekretin e produktivitetit që është thelbësor për suksesin e saj "Ajo punon gjatë gjithë kohës."

Dhe kur them gjatë gjithë kohës: pra të paktën 20 orë në ditë, në një ditë të plotë 24-orëshe disa herë në muaj, dhe me vetëm 1 javë pushim në vit. Unë e di që shumë nga ju mund të thonë: është si Margaret Thatcher. "Unë nuk shkoj të fle

derisa të jem aq i lodhur sa gati më zë gjumi në dysheme. Nëse arrij të fle 4 orë, ajo është një natë e mirë për mua" - i tha Steel intervistuesit

Në pamje të parë, tek kjo shkrimtare ka diçka që ka të bëjë me këmbëngulje e madhe: Nëse do të shkruash shumë, shkruaj më shumë! Edhe në uebsajtin e biznesit Quartz thuhet: "Si t'i realizoni gjërat? Duke i bërë. A nuk është fantastike?"

Por, si një terapist tërësisht i pakualifikuar, që për këtë arsye është kundër diagnostikimit të figurave publike nga distanca, unë do të doja të ofroja një interpretim alternativ: Steel ka një problem.

Para lindjes së ekonomisë së profesionistëve të lirë (freelancer), që e bëri të detyrueshëm tregimin e një

angazhimi të pandërprerë si provë se ju jeni një "punë-mbaruar", ne e quajtmë këtë workaholism - një mani kompulsive për të punuar pa pushim, ndoshta për shkak të ankthit, apo vetëvlerësimit të ulët, apo dëshirës për të shmangur përfshirjen në ndonjë aspekt më të vështirë të jetës.

Unë nuk jam as i sigurt nëse Steel, e cila me siguri që e ka njohur vuajtjen, do të pajtohej me mua. "Puna që bëj është vendi ku unë gjej strehë. Edhe kur kanë ndodhur gjëra të këqija në jetën time personale, ajo është një konstante. Është diçka solide tek e cila mund të arratisem" - u shpreh Steel në atë intervistë.

Duke sugjeruar që romancierja është e rrënuar psikologjikisht, unë duhet të sqaroj se nuk po

nënkuptoj as kritikën më të vogël ndaj saj. Ne të gjithë jemi të rrënuar psikologjikisht, në shkallë më të madhe ose më të vogël, dhe ne e shfaqim vazhdimisht atë në veprimet tona të përditshme.

Në fakt, sipas një pikëpamje të psikologjisë - e lidhur zakonisht me psikanalizën e shkollës së vjetër - ju mund ta shihni biografinë e secilit person si diçka më shumë se sa thjesht një përpjekje të vazhdueshme për të bërë paqe me sjelljet e çuditshme vetjake, edukimin e tyre të hershëm dhe ngjarjet e dhimbshme të jetës së tyre.

E vetmja gjë vërtetë e pazakontë në lidhje me praktikën e punës së Steel, është se ajo u ka sjellë kënaqësi miliona lexuesve. Shpesh, duke punuar mbi problemet tona, ne padashur e bëjmë jetën më të keqe për ata

që na rrethojnë.

Megjithatë, kjo mënyrë e të parit të gjërave është një kujtesë se ju nuk duhet ta keni zili Steel për produktivitetin e saj, apo të arrini në përfundimin se "ne ndoshta nuk po përpiqemi sa duhet". Së pari, ju keni bërë zgjidhjet tuaja personale. Përveç kësaj, nëse ju mungon motivimi specifik që ju çon drejt praktikave hiper-produktive që kanë disa njerëz, përpjekja për t'i imituar ata ndoshta do të dështojë.

Ata duan të bëjnë një punë të madhe, ndërsa ju dëshironi të jeni lloji i personit që dëshiron të bëjë një sasi të madhe pune, çka nuk është e njëjta gjë. Është një gjë të jesh i motivuar, dhe krejtësisht diçka tjetër të krijosh vullnetin për t'u sjellë në atë mënyrë. / "The Guardian" - Bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Ballkani mposht Prishtinën në derbi, Gjilani triumfon ndaj 'Niklit'

Ballkani ka shijuar fitoren e parë në përballje me kampionen në fuqi, Prishtinën. Tri pikë mori edhe skuadra e Ismet Munishit, Gjilani, në përballje me Feronikelin. Sot (e hënë) zhvillohet ndeshja e fundit për xhiron e dytë në mes të Dukagjinit - Drenicës

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 GUSHT - Skuadra e Ballkanit e ka fituar derbin ndaj Prishtinës në "Fadil Vokrri" me rezultat minimal 0-1, ndërsa në ndeshjen tjetër Gjilani triumfoi kundër Feronikelit (1-0).

Prishtina dhe Ballkani, që janë dy nga favoritët për titullin e kampionit në Superligë, kanë zhvilluar një përballje të fortë, derisa golin e vetëm në këtë takim e realizoi mesfushori i talentuar Ermal Krasniqi që, në fakt, ishte supergol nga distanca (51). Ballkani mbeti me 10 lojtarë në fushë pasi Kushtrim Gashi u ndëshkua me të kuq, pas dy kartonëve të verdhë (74'). Por, pavarësisht këtij ndëshkimi, kryeqytetasit nuk shënuan. Skuadra e Ballkanit me tri pikët e reja ngrehet në pozitën e dytë me katër pikë, kurse Prishtina në vendin e tetë me



një pikë. Në ndeshjen tjetër që u zhvillua në Drenas, Feronikeli pësoi humbje nga Gjilani (0-1). Golin e vetëm në këtë ndeshje e realizoi Progni në minutën e 66. Skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi shënoi gol edhe në pjesën e parë, por u anulua pas rishikimit të VAR-it. Gjilani grumbullon katër pikë duke u renditur i katërti, derisa Feronikeli mbetet në fund pa asnjë pikë. Skuadra nënkampione, Drita, ka barazuar pa gola para tifozëve të vet në duel me fituesin e Kupës dhe Superkupës, Llapin. Ndeshja u përshkrua me lojë të fortë dhe rivalitet, e ku në disa raste u nevojiti ndërhyrja e VAR-it për të sqaruar gjërat, siç ishte rasti i kartonit të kuq për portierin e llapjanëve, Marjan

Çoriq, në minutën e 58 dhe për golin e shënuar të mysafirëve nga Adem Maliqi në minutën e 83-të. Pas rishikimit të rasteve me VAR, gjyqtari Vigan Ibërdeماج vendosi për anulimin e kartonit të kuq për portierin si dhe anulimin e golit për shkak se paraprakisht u shkaktua faull. Në ndeshjen tjetër Malisheva shënoi fitoren e parë në elitë si mysafire kundër Ulpianës, me rezultat 3-1. Dy gola për Malishevën i realizoi Hasan Hyseni (30 dhe 59), derisa me një gol kontribuoi Torvioll Stullçaku (56). Golin e nderit për Ulpianën e realizoi Marclei Santos. Për Malishevën kjo ishte fitorja e parë në elitën e futbollit të Kosovës, pasi në javën e parë kishte barazuar në shtëpi me Prishtinën (1-1).

SHKURT

Avdijaj transferohet te Hartbergu

Skuadra austriake TSV Hartberg ka njoftuar për marrëveshjen e arritur me mesfushorin nga Kosova, Donis Avdijaj. Avdijaj, i cili në të kaluarën shihej si mesfushori më premtues sa ishte te Schalke 04, ka nënshkruar kontratë dyvjeçare. Skuadra austriake e ka njoftuar marrëveshjen përmes një komunikate në "Twitter": "Përshëndetje Donis! 25-vjeçari ofensivë Donis Avdijaj kalon te skuadra jonë TSV Egger Glas Hartbeg dhe nënshkruan deri në verën e 2023-s".

Rashani sërish shënon në Ligën 1

Elbasan Rashani ka vazhduar formën e mirë edhe këtë javë te skuadra franceze Clermont. Në ndeshjen që është zhvilluar në mes të Clermont dhe FC Metz në kuadër të Ligës 1, Rashani ka shënuar gol. Rashani e ka shënuar golin e barazimit në minutën e 58-të, për 2-2. Në javën e kaluar Rashani shënoi dy gola kundër Lyonit, duke ia siguruar 1 pikë në fund të ndeshjes Clermontit.

Wendell Mitchell përforcon KB Prishtina

KB Sigal Prishtina ka njoftuar për transferimin edhe të një basketbollisti të huaj. Bëhet fjalë për Wendell Mitchell, i cili sot ka nënshkruar dhe është paraqitur nga klubi kryeqytetas. "Wendell i lumtur të jetë pjesë e klubit më të trofeshëm shqiptar Sigal Prishtina. Sot në zyrat e klubit, në prani të presidentit Burim Maraj dhe drejtorit Edmond Azemi, basketbollisti Wendell Mitchell nënshkroi kontratën me klubin më të suksesshëm shqiptar Sigal Prishtina. Ai u shpreh se është shumë i kënaqur me menaxhmentin dhe me pritjen që i është bërë në Prishtinë. Wendell premtoj përkushtim dhe profesionalizëm në rrugëtimin e përbashkët drejt sukseseve", thuhet në njoftimin e Klubit të Prishtinës.

SUPERLIGA

Prishtina - Ballkani	0-1
Feronikeli - Gjilani	0-1
Drita - Llapi	0-0
Ulpiana - Malisheva	1-3

Të hënë takohen:
17:00 Dukagjini - Drenica

Tabela

1. Malisheva	4 pikë
2. Ballkani	4
3. Drita	4
4. Gjilani	4
5. Llapi	2
6. Dukagjini	1
7. Drenica	1
8. Prishtina	1
9. Ulpiana	1
10. Feronikeli	1

Challandesit sot mban konferencë për media, në mbrëmje stërvitin 'Dardanët'

PRISHTINË, 29 GUSHT - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll po përgatitet për t'i zhvilluar tri ndeshjet e radhës në kuadër të kualifikimeve për në Kampionatin Botëror. "Dardanët" do të ballafaqohen me Gjeorgjinë më 2

shtator në udhëtim, pastaj me Greqinë dhe Spanjën më 5 dhe 8 shtator si vendas në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Trajneri Bernard Challandes do të paraqitet të hënë në një konferencë para mediave për të

folur rreth ndeshjes së parë me Gjeorgjinë me fillim nga ora 11:00. Në po të njëjtën ditë skuadra do të zhvillojë stërvitje në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë me fillim nga ora 19:00.



Prishtina merr edhe një futbollist cilësor, Kadrabeci zbarkon në 'Fadil Vokrri'

PRISHTINË, 29 GUSHT - Klubi i Futbollit Prishtina ka njoftuar se ka nënshkruar me mesfushorin Erando Kadrabeci. Kampioni aktual në fuqi ka vazhduar transferimet për sezonin e ri, pasi synon që ta mbrojë titullin. "Mesfushori i shquar i Superligës Shqiptare, Erando Kadrabeci, ka nënshkruar me kampionin aktual të Kosovës, Prishtina. Erando

Karabeci, pas përvojës disavjeçare në futbollin shqiptar, duke korrur suksese të jashtëzakonshme personale dhe kolektive, arrin marrëveshje për bashkëpunim me kampionin aktual të Kosovës, FC Prishtina", thuhet në njoftimin e Prishtinës. Karabeci karrierën e filloi te Partizani, ku ishte pjesë e tij deri në vitin 2009, pastaj te Tirana (2009-

2013), prej ku huazohet te Kukësi për dy muaj në vitin (2013) në garat evropiane, pastaj kthehet sërish te Tirana deri në vitin (2020) dhe krejt në fund kalon te Teuta e Durrësit në edicionin e fundit (2020-2021). Vlen të theksohet që Karabeci me dy skuadrat e fundit në dy vjetet e fundit arrin të shpallet kampion i Shqipërisë në futboll.



Reja: Kemi bërë përparim, ky grup mund të na japë kënaqësi të mëdha

IRANË, 29 GUSHT - Në prag të nisjes së grumbullimit për eliminatoret e Kupës së Botës Katar 2022, trajneri Edi Reja dha një prononcim nga shtëpia e tij në Itali, ku shpjegoi edhe zgjedhjet që ka bërë në listën e futbollistëve që ka ftuar për ndeshjet e fillimit të shtatorit. "Kemi një listë prej 30 lojtarësh, por kemi edhe probleme me dëmtimet, si me Dermakun, Veselin e Lenjanin, të cilët duan disa javë për t'u rikthyer në fushë. Balliu po bën shumë mirë te Rayo Vallecano në La Liga dhe kam folur me të në telefon, por vuan nga pubalgjia dhe nesër do të vendosim nëse do të vijë apo jo. E njëjta situatë është edhe me Xhakën, që vjen pas një dëmtimi 6-mujor në gju dhe nuk ndihet ende gati për të dhënë kontributin e tij, megjithatë edhe në këtë rast e kemi lënë që të vendosim në mënyrë të sinqertë, në dy ditët e ardhshme. Ndërkohë vjen për herë të parë me ne edhe Ernest Muçi, që ka qenë pjesë e Shqipërisë U21 dhe e ndjekim prej disa kohësh, pasi është vetëm 20 vjeç. Kemi, gjithashtu, edhe Çepelen, që e njihni tashmë. Misioni është të integrojmë këta të rinj së bashku, si Broja, Çokaj, Çepele e Muçi, të cilët janë vërtet futbollistë me perspektivë. Pjesa tjetër janë futbollistë të grupit që e kemi krijuar tashmë", ka thënë trajneri italian.



Një pjesë e mirë e futbollistëve që ka vendosur të grumbullojë trajneri Reja po bëjnë lojë mjaft të mirë në skuadrat përkatëse dhe po luajnë rregullisht, teksa vetë tekniku italian pranon se është i kënaqur me aktivizimin e tyre. "Po bën shumë mirë Çekiçi, që është transferuar në klubin e Cikalleshit dhe të dy po luajnë rregullisht në formacion. Ka shumë lojtarë që po luajnë rregullisht, por më vjen keq për Berishën e Strakoshën që po qëndrojnë në stol, por që meritojnë shumë më tepër besim. Ata stërviten rregullisht, por ndoshta nuk i kanë reflektet e ndeshjes, pasi nuk po luajnë. Pjesa tjetër si Gjimshiti e Ismajli luajnë rregullisht, ndërsa Kumbulla është shumë mirë, ndonëse nuk ka luajtur në javët e fundit. Edhe Hysaj, Doka, Roshi, Trashit e Mitaj po luajnë rregullisht, ashtu si Bare e Laçi. Kemi edhe Manajn që nuk po luan, por stërvitet me ekipin e parë të Barcelonës dhe gjatë verës ka bërë mirë në disa miqësore. Më ka thënë se është në formë mjaft të mirë, edhe pse nuk luan", është shprehur Reja. Nedin Bajrami mund të jetë një tjetër risi e përfaqësueses kuqezi, pasi mesfushori që po spikat me Empolin edhe në Serinë A, pret miratimin nga FIFA që ta veshë fanellën kuqezi, teksa trajneri Reja pranon se mirëpret një futbollist me cilësitë e tij në grup. "Sa i përket Bajramit, presim vendimin e kësaj seance gjyqësore. Kam folur me të dhe babanë e tij, dhe të dy më kanë konfirmuar se dëshiron të luajë për Shqipërinë, por ekziston ky ngërç ligjor. Përgjigjen do ta kemi të hënën, ose maksimumi të martën, pasi këto janë datat e FIFA-s dhe duhet të presim. Unë uroj që të mund të vijë të luajë me ne, pasi është një lojtar që mund të na japë diçka më

shumë nga mesfusha e përpara, për vetë cilësitë që ka, pasi driblon mirë dhe godet shpesh portën. Ka pasime shumë cilësore filtruese dhe do të ishte një vlerë e shtuar për grupin tonë", u shpreh trajneri. Kuqezinjtë do të luajnë tri ndeshje në harkun e 6 ditëve, teksa Reja pranon se kalendari është vërtet i ngjeshur, por shton se ka besim te cilësitë e lojtarëve të tij dhe pret që sidomos ndaj Hungarisë e Polonisë, të marrë një tjetër sinjal të rritjes së tyre. "Të luash çdo tri ditë nuk është asnjëherë mirë, por kjo vlen edhe për kundërshtarët tanë, ndaj në këtë pikë jemi të barabartë. Unë jam i bindur që ky grup mund të bëjë mirë, pasi jemi rritur dhe kemi fituar përvojë të rëndësishme. Miqësoret ndaj Uellsit dhe Republikës Çeke kanë qenë shumë të rëndësishme, pasi kemi qenë konkurrues me dy përfaqësues që kanë marrë pjesë në Evropian. Jemi përmirësuar me lojën nga mesfusha e para, pasi djemtë tani janë më të lirshëm dhe më të bindur në atë që duan të bëjnë. Dimë shumë mirë vlerat tona, por në të njëjtën kohë edhe defektet tona, ndaj do të provojmë të korrigjohemi gjatë këtyre ditëve, për t'u paraqitur sa më mirë në eliminatore. Luajmë kundër dy skuadrave shumë të forta si Hungaria dhe mbi të gjitha Polonia, të cilat kanë treguar se janë përpara nesh në aspektin e cilësisë, por edhe ne duam të tregojmë se nuk mbetemi mbrapa. Unë jam i bindur, që nëse të gjithë jemi në gjendjen optimale, mund të marrim shumë kënaqësi prej kësaj skuadre. Më mungojnë të dëmtuarit, sepse do të kisha më shumë mundësi zgjedhjeje, megjithatë do të luajnë më të mirët dhe do të provojmë të bëjmë më të mirën në fushë", ka deklaruar Reja.

SHKURT

Ronaldo tek Unitedi do të fitojë më pak se te Juventusit

Cristiano Ronaldo do të përfitojë më pak te Manchester Unitedi sesa te Juventusit. "Daily Mail" ka zbuluar se fundmi pagën e vërtetë të portugezit, i cili do të marrë 20 milionë paund në sezon, e kthyer në euro 23.34 milionë euro neto në sezon. Te Juventusit CR7 përfitonte 31 milionë euro në sezon. Kjo ulje page tregon sakrificën që Ronaldo ka bërë për t'u kthyer në "Old Trafford". Një zgjedhje e befasishme e portugezit, i cili fillimisht u duk shumë pranë një transferimi te Cityt, por më pas gjithçka ndryshoi brenda pak orësh.

Quartararo fiton në Britani dhe thellon diferencat për titullin

Fabio Quartararo ka fituar Çmimin e Madh të Britanisë, etapa e 12 e MotoGP, duke thelluar diferencat me ndjekësit në renditjen e përgjithshme të pilotëve. Lideri i renditjes ka fituar në Silverstone para Suzukit të Rins dhe Apirlas së Aleix Espargaro. Vendi i katëmbëdhjetë për Francesco Bagnaian, ndërsa Valentino Rossi e ka mbyllur në vendin e tetëmbëdhjetë. Marc Marquez (Honda) ka rënë në fillimin e garës dhe është tërhequr.

Bayerni ia merr Leipzigit edhe Sabitzerin

Bayern Munchen raportohet se ka arritur marrëveshje me Red Bull Leipzigit për transferimin e Marcel Sabitzerit. Edhe Sabitzer ka rënë dakord me kushtet e ofruara nga kampioni gjerman, teksa edhe dëshira e lojtarit ishte që të transferohej në "Allianz Arena". "Bild" raporton se marrëveshja tashmë është arritur, teksa "Bavarezët" do të paguajnë rreth 16 milionë euro për mesfushorin austriak. 27-vjeçari do të nënshkruajë kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2026. Zyrtarizimi i Marcel Sabitzer nga Bayern Munichu pritet të bëhet së shpejti.

Reali kërkon rrugë të tjera për transferimin Mbappes

Shtohen orë pas ore aktorët protagonistë të operacionit të bujshëm, por Real Madridi mbetet në pritje të një përgjigje nga Parisi për Kylian Mbappen. Sipas "FootMercato", shumë ndërmjetës të nivelit të lartë po kërkojnë të ndihmojnë Florentino Perez që të mbyllë superoperacionin. Mes këtyre, lexohet, është edhe menaxheri i Cristiano Ronaldos, Jorge Mendes, dhe ai i Richarlison (objektivi i Paris Saint-Germain për të zëvendësuar Mbappen), Kia Joorabchian. Të gjithë në punë për të ndërmjetësuar mes dy klubeve dhe për ta gjetur pikën e ekuilibrit mes kërkesës dhe ofertës, pak orë para mbylljes së merkatos.

CAS kundër LaLiga, duhet t'i lejojë lojtarët të grumbullohen me kombëtaret

CAS ka refuzuar kërkesën e LaLiga për ta hedhur poshtë vendimin e FIFA-s që zgjati dy ditë afatin ndërkombëtar për ndeshjet kualifikuese të Kupës së Botës në Amerikën Latine. CONMEBOL e

kishte bërë këtë kërkesë, që gjeti pajtimin e FIFA. Presidenti Gianni Infantino kishte kërkuar solidaritet nga klubet, prej situatës së krijuar në gjithë botën prej masave kundër Covidit. FIFA, në

komunikatën e saj ditën e sotme, shkruan se pret që LaLiga të njohë vendimin e saj, që u ligjërua me vendimin e sotëm që mori CAS. LaLiga nga krahu tjetër premton se do ta vazhdojë betejën

ligjore, pasi shtyrja e grumbullimeve ia dëmton garat. Gjithashtu, është vendosur që të shtyhen dy ndeshje të kampionatit, Villarreal-Deportivo Alaves dhe Sevilla-Barcelona.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

